REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE
48/20
Date/Datum. 11.03.2020
PRISHTINË - PRIŠTINA

PSH.nr. 48/20

PANELI SHQYRTUES, i emëruar nga Kryetari i OSHP-së, në bazë të nenit 105 dhe nenit 106 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042,i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068 dhe Ligjin 05/ L-092, në përbërje të: z. Goran Milenković - Kryetar, z. Nuhi Paçarizi -Referues, z. Blerim Dina - Anëtar, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga operatori ekonomik: "Telekomi i Kosovës" sha – Prishtinë, kundër njoftimit për kontratë lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Furnizim dhe shërbime te internetit VPN dhe WLAN për Universitetin e Prishtinës "Hasan Prishtina", me nr prokurimi: 242-19-9669-2-2-1,iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/- Universiteti "Hasan Prishtina", më datën: 12.02.2020, mori këtë:

V E N D I M

I. **APROVOHET,** si pjesërisht e bazuar ankesa e operatorit ekonomik "Telekomi i Kosovës" lidhur me aktivitetin e prokurimit me: "Furnizim dhe shërbime te internetit VPN dhe WLAN për Universitetin e Prishtinës "Hasan Prishtina", me nr prokurimi: 242-19-9669-2-2-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/ Universiteti "Hasan Prishtina".

II.**ANULOHET**, njoftimi për kontratë lidhur me aktivitetin të prokurimit me titull "Furnizim dhe shërbime te internetit VPN dhe WLAN për Universitetin e Prishtinës "Hasan Prishtina", me nr prokurimi: 242-19-9669-2-2-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/ Universiteti "Hasan Prishtina".

III. Autoriteti Kontraktues në afat prej 10 ditësh duhet ta informoj me shkrim Panelin Shqyrtues për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit.

IV. Mos respektimi i këtij vendimi, detyron Panelin shqyrtues që konform dispozitave ligjore të nenit 131 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, të ndërmarr masa ndaj Autoritetit Kontraktues.

V. Me qenë se ankesa e operatorit ekonomik ankues: "Telekomi i Kosovës" aprovohet si pjesërisht e bazuar, i bëhet kthimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës.

VI. Obligohet operatori ekonomik ankues që konform nenit 33 pika 6 të rregullores së punës së OSHP- së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën ju bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

A R S Y E T I M

Sqarim rreth inicialeve për procesin e prokurimit :
Autoriteti kontraktues në tekstin e më poshtëm AK ;
Operatori ekonomik në tekstin e më poshtëm OE ;
Dosja e Tenderit në tekstin e më poshtëm DT ;
Njoftimi për Kontratë në tekstin e me poshtëm NJpK ;
Ligji për Prokurim Publik-në tekstin e me poshtëm LPP;
Rregullat dhe Udhëzuesi Operativ për Prokurim Publiken tekstin e me poshtëm- RRUOPP
Organi Shqyrtues i Prokurimit në tekstin e me poshtëm –OSHP;
Komisioni Rregullativ për Prokurim Publik në tekstin e me poshtëm -KRPP
Operatori ekonomik ankues "Telekomi i Kosovës" sha – Prishtinë, si palë e pa kënaqur ka deponuar ankesë në OSHP, me 20.01.2020 me nr. 48/20, kundër njoftimit për kontratë lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Furnizim dhe shërbime te internetit VPN dhe WLAN për Universitetin e Prishtinës "Hasan Prishtina", me nr prokurimi: 242-19-9669-2-2-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/ Universiteti "Hasan Prishtina", duke pretenduar se:

- Autoriteti kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenin: 9.4 të Ligjit për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës.

Organi Shqyrtues i Prokurimit, konform nenit 113 dhe 114 të LPP-së me datë: 22.01.2020, ka autorizuar ekspertin shqyrtues për të shqyrtuar vlefshmërinë e të gjitha pretendimeve të palës ankimore.

Eksperti shqyrtues në raportin e dt: 27.01.2020, lidhur me pretendimin ankimore të OE-ankues sqaron si në vijim: Sqarim Hyrës: Autoriteti Kontraktues - "Universitetit "Hasan Prishtina", gjatë këtij aktiviteti të prokurimit ka zbatuar procedure të hapur, lloji i kontratës është shërbim (kornizë 36 muaj) me vlerë të mesme. Pretendimet kryesore ankimore kanë të bëjnë kundër njoftimit për kontratë.

- Kundër të njëjtit njoftimi parashtruesi i ankesës "Telekomi i Kosovës" sha, më datën 03.01.2020, ka paraqitur kërkese për rishqyrtim pran AK-se, me pretendimet e njëjta ankimore si ne ankesën e dorëzuar ne

OSHP.

Përgjigjeje në pretendimin ankimore 1 (neni 113) :Pretendimet kryesore ankimore kanë të bëjnë kundër procedurës së aplikuar nga autoriteti kontraktues, rrjedhimisht kërkohet anulimi i kësaj procedure me qellim që AK–Universiteti "Hasan Prishtina", për këto shërbime të përjashtohet nga legjislacioni për prokurim publik, në kuptimin që të aplikohet procedura e negociuar pa publikim të njoftimit me arsyetimin se një gjë të tillë e parasheh neni 9, paragrafi 4, i LPP-s, si dhe një interpretim i dhëne nga KRPP.

- Sa i përket nenin 9, si tërësi, përfshirë edhe paragrafin 4, vlerësimi ynë është se dispozitat e të njëjtit nenë, sqarojnë vlerësimin dhe planifikimin paraprak të prokurimit sipas nevojave që ka një Autoritet Kontraktues i caktuar, por assesi përjashtimin nga procedura e prokurimit publik apo të drejtën për aplikim të procedurës së negociuar pa publikim të njoftimit. Për të njëjtën procedurë dispozitat e nenit 35, të LPP-s, janë të qarta dhe sqarohet kur një Autoritet Kontraktues mund të përdor procedurat e negociuara pa publikim paraprak të njoftimit.

Parashtruesi i ankesës "Telekomi i Kosovës" sha,është thirrur edhe ne praktikat e me paraprake te vendim marrjes në OSHP, përkatësisht i është referuar vendimeve me nr.338/19, të datës 16.08.2019 dhe nr. 409/19, te datës 04.09.2019. Arsyetimet e vendimeve te larte përshkruara kryesisht thirren ne marrëveshjen lidhur nga "Telekomi i Kosovës", tani ne cilësi te OE-s, dhe "Ministres se Administratës Publike" (MAP), marrëveshje e cila është e vlefshme deri me datën 31.03.2019, ku janë te përfshira edhe shërbimet, objekt i kësaj procedure te prokurimit.

Përfundimisht sipas asaj qe u përshkrua me larte vlerësimi ynë është qe AK/ Universiteti i Prishtinës "Hasan Prishtina", ka iniciuar procedure te prokurimit në mbështetje të dispozitave te LPP-se,(AK ka iniciuar kontrate kornize 3 vjeçare).Përkatësisht meqë marrëveshja e lidhur nga "Telekomi i Kosovës", dhe "Ministres se Administratës Publike" (MAP), skadon me datën 31.03.2020, ti lejohet AK/ Universitetit "Hasan Prishtina", të procedoj tutje me aktivitetin e prokurimit sipas dispozitave te LPP-se.

Mendimi i ekspertit shqyrtues: Bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues, "Telekomi i Kosovës", të refuzohet si e pa bazuar, dhe AK-së – Universitetit te Prishtinës "Hasan Prishtina", ti lejohet te procedoj tutje me procedurat e prokurimit.

Operatori Ekonomik, me datë: 28.01.2020, me anë të parashtresës, ka njoftuar OSHP-në, se nuk pajtohet me mendimin e ekspertit shqyrtues.

Në seancën e shqyrtimit kryesor të datës: 12.02.2020, ku kanë qenë prezent të gjithë anëtarët e panelit shqyrtues, përfaqësuesi i OE-së ankues, përfaqësuesi i AK-së, në seancë është edhe eksperti shqyrtues, ku u

shqyrtuan shkresat e lëndës duke e bërë kontrollimin dhe analizimin e dokumentacionit për procedurën e prokurimit i cili përbëhet nga: autorizimi i inicimit të aktivitetit të prokurimit, njoftimi për kontratë, procesverbali mbi hapjen e ofertave, vendimi mbi themelimin e komisionit të vlerësimit të ofertave, raporti i vlerësimit të ofertave, ankesa e operatorit ekonomik, raporti i ekspertizës të OSHP-së, parashtresat e palëve në procedurë.

Gjatë prezantimit në seancë përfaqësuesi i OE-së ankues z. Prebreza deklaroj: Fillimisht ju njoftojmë se "Telekomi i Kosovës" qëndron prapa ankesës dhe konstatimit se Autoriteti Kontraktues UP nuk ka respektuar dispozitat e LPP-së nenin 9.4 ashtu siç është e cekur në ankese. Me ketë rast dua fillimisht të sqaroj arsyetimin e dhëne nga Autoriteti Kontraktues, aty thuhet se Autoriteti Kontraktues UP pa diskriminuar asnjë OE nuk mund te lidhe kontrate një burimore me asnjë OE ku këto shërbime ofrohen, mendoj se ky sqarim është i pa saktë mund ti ofroj panelit një kontrate të nënshkruar nga Autoriteti Kontraktues Telekomi i Kosovës dhe UP Hasan Prishtina përfaqësuesi i OE panelit ia dorëzoj Marrëveshjen mbi shfrytëzimin e kontratës publike kornizë për ofrimin e shërbimeve telekomunikuese e lidhur ne mes Ministrisë se Administratës Publike dhe Telekomit të Kosovës Sh.a., me të njëjtën procedure mund të shfrytëzohen edhe shërbimet e njëjta qe janë kontestuese sot ne këtë seance. Sipas informatave thotë se MAP nuk e ka shfrytëzuar këtë shërbim. Raporti i ekspertit shqyrtues ne edhe me shkrim e kemi kundërshtuar atë, mendojmë qe raporti duhet te hedhet poshtë dhe te mos merret parasysh nga PSH, është bërë me nguti ka disa gabime formale, OE ne faqe 4 i referohet me emër të ndryshëm, ne aspektin e përmbajtjes me informata shtese në bazë të informatave sqaruese OE nuk ju është bërë. Pretendimi ynë ne ankese është neni 9.4, eksperti shqyrtues z Bibaj e ka dhëne një sqarim me këtë nen, mirëpo unë ia parashtroj panelit interpretimin ligjor nga KRPP ia dorëzon panelit përfaqësuesi i OE si dëshmi dhe i është referuar Aktvendimeve te OSHP te marruar me herët edhe thotë se ato vendime të OSHP kryesisht thirren ne mes Telekomit dhe MAPIT dhe është e pa saktë, unë kam edhe vendimin qe i është referuar Eksperti Shqyrtues por edhe vendimi i Kuvendit dhe vendimit te UN Hagji Zeka" Citoj paneli shqyrtues vlerëson se Universiteti Kadri Zeka dhe Telekomi i Kosovës duhet te bashkëpunojmë detyrimisht për këto shërbime qe i duhen Universitetit, kontratat e përmendura ne rastin e Kuvendit dhe UP Kadri Zeka, këto kanë pas marrëveshje për shfrytëzimin e shërbimeve tona për këtë arsye janë përmendur ne raportin e Eksperti Shqyrtues.

Sqarim nga përfaqësuesi i OE-se prapë e sqaroj se baza ligjore me të cilën është nënshkruar ajo marrëveshje është bazë e njëjte qe mund të nënshkruhet marrëveshje e njëjta, këtu edhe teme mos respektimi i procedurave te LPP-së, ne kemi pas 2 takime zyrtare me Autoriteti Kontraktues në zyrën e sekretarit dhe rektorit kam qenë pjesëmarrës Autoriteti Kontraktues i din arsyet e veta pse ka iniciuar procedurë, ajo çka thotë Eksperti Shqyrtues nuk qëndron te 2 ankesat qe kam përmend 338 , Kontrata e Mapit nuk janë përmendur janë përmendur kontratat qe kemi me Kuvendin e Kosovës. Unë i kam te 2 vendimet qe i cekem.

Gjatë prezantimit në seancë përfaqësuesit të AK-së ankues z. Qorri deklaroj: UP Hasan Prishtina pajtohet me mendimin e Eksperti Shqyrtues sa i përket marrëveshjes ne e cekim se kjo nuk qëndron për shërbimet qe kemi kërkuar shërbime të telefonisë mobile dhe Fikse, gjithashtu kjo marrëveshje skadon me 31.03.2020, po ashtu edhe ne pjesën e 2-te shënimet qe janë ne këtë marrëveshje e cila është e nënshkruar nga te dy palët këtu me shume flet për furnizim me Numra se sa për furnizim me internet. Ne sqarojmë sa here kemi kontakt me Autoriteti Kontraktues ne kemi kërkuar të vine ne zyre ti shikojmë këto marrëveshje, për të ripërtëri marrëveshjen sepse përfundon me 31.03.2020. Për pjesën tjetër na sqaron eksperti i fushës se IT-se z. Tahiri : puna e marrëveshjes ne fjale jam i njoftuar me sekretarin dhe udhëzimet qe ia kam dhëne për këtë marrëveshje këto janë shërbime diçka tjetër te cilat nuk janë dal ne ofertën e tenderit, nuk e kam pa te arsyeshme te ndërpremë sepse OE te tjerë nuk mund te dhëne shërbime siç jep Telekomi. Sa i përket marrëveshjes ne fjale ne aspektin e kontratës qe kanë marrëveshje me MAPi-n është një ndryshim i madh me çmimin e tregut qe ofrojnë OE-te tjerë, arsyeja kryesore qe kemi propozuar te dalim është sepse oferta është shume e madhe ne krahasim me ofertat tjerë, ndryshimi i çmimit për një vit nëse ne nënshkruajmë me Telekomin ka qenë 75.180.00 euro. Dhe për këtë pune kanë thënë nuk është e nevojshme te nënshkruaj këtë kontrate. Sipas Përfaqësuesit te OE Neve po na përshtatkan kërkesat e tyre dhe do te bëjnë një matje unë nuk e kam pa reale dhe kam thënë të bëjnë shpallje te ofertojnë OE te ngjashëm po ashtu edhe Telekomi të oferton.

Gjatë prezantimit në seancë Eksperti Shqyrtues z. Bibaj deklaroj: Telekomi sipas OE ka kërkuar anulim të AP me qellim te përdoret procedura e negociuar. Autoriteti Kontraktues unë kam vlerësuar se ka njoftua procedurë sipas LPP-së ne fuqi, përmes raportit po ashtu kam sqaruar se neni 9.4 i LPP-së thirret ne diçka tjetër asesi nuk lejon qe te bëhen procedurat neni 35 flet për një gjë te tillë. Ankuesi ka përmend edhe disa vendime te me hershme te OSHP-së marrëveshja e Telekomit dhe Mapit për shfrytëzimin e internetit. Marrëveshja e njëjtë skadon me 31.03.2020 AK ka iniciuar kontrate kornize për 36 muaj prandaj kam propozua të lejohet Autoriteti Kontraktues të vazhdoj me procedure.

Në fjalën përfundimtare përfaqësuesi i OE-së deklaroj: Kërkojmë nga paneli shqyrtues qe raporti i ekspertit shqyrtues të hidhet poshtë dhe të mos merret për bazë dhe kërkojmë qe Vendimi i Autoritetit Kontraktues të anulohet dhe të veprohet sipas nenin 9.4.të LPP-së.

Në fjalën përfundimtare përfaqësuesi i AK-së deklaroj: Kërkojmë nga paneli shqyrtues të hedhet poshtë ankesa e OE si e pa bazuar dhe te mbetet ne fuqi vendimi i Autoritetit Kontraktues.

Paneli shqyrtues pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, shqyrtimit të pretendimeve ankimore të OE ankues, konstatimeve, analizës konkrete dhe rekomandimeve të ekspertit shqyrtues deklarimit të palëve në procedurë,

diskutimeve dhe shoshitjes së provave në tërësi gjatë seancës për shqyrtim kryesor, sqaron se ankesa është parashtruar kundër njoftimit për kontratë.

Lidhur me pretendimin e OE ankues "Telekomi i Kosovës" sha, që ka të bëjë kundër procedurës së aplikuar nga autoriteti kontraktues, duke pretenduar se AK ka vepruar në kundërshtim me nenin 9.4 të LPP-së, duke kërkuar anulimin e kësaj procedure me qëllim që AK–Universiteti "Hasan Prishtina" për këto shërbime të përjashtohet nga legjislacioni për prokurim publik, në kuptimin që të aplikohet procedura e negociuar pa publikim të njoftimit me arsyetimin se një gjë të tillë e parasheh neni 9, paragrafi 4, i LPP-s, si dhe një interpretim i dhënë nga KRPP.

Paneli shqyrtues sqaron se Komisioni Rregullativ për Prokurim Publik ka lëshuar një interpretim në lidhje me pretendimin e OE ankues për mosrespektim të nenit 9.4 të LPP-së, nga autoritetet kontraktuese ku ka sqaruar si në vijim: "Nëse autoriteti kontraktues është autoritet publik, autoriteti i tillë publik duhet të marrë masa të arsyeshme për t'u siguruar se lëndët që i përmbushin këto nevoja nuk janë në dispozicion nga ndonjë autoritet tjetër publik". Pra neni i lartcituar rregullon rastet kur Autoriteti Kontraktues (Autoriteti Publik) ka nevojë për sigurimin e shërbimeve operator i të cilave po ashtu është një autoritet publik. LPP, nuk e sqaron me tej se si autoritet publike do te rregullojnë plotësimin e nevojave te tyre (ne mes vete) meqë kjo është çështje e autoriteteve publike dhe/ose rregullave tjera. Mirëpo është më se e qartë se këto raste kanë të bëjnë me përjashtimet nga zbatimi i legjislacionit që rregullon prokurimin publik kur një formë e partneritetit publiko privat realizohet (një AK mund të kërkojë ofrimin e një shërbimi në shërbimet e tij ose shërbimeve te një autoriteti tjetër kontraktues pa iniciuar ndonjë procedurë tenderimi, të ashtuquajtura përjashtim "blerje në shtëpi"). Si përfundim pas analizimit të cekur më lartë (neni 9.4 të LPP-së) dhe të kërkesave tuaja, meqë nuk ka asnjë dispozitë tjetër të LPP-ës e cila i obligon Autoritetet Publike që të marrin masa për të mos lejuar "shtrembërimin e konkurrencës" (sikur ato nga direktiva e BE-ës, neni 12.1) KRPP nuk ka se si të mos e trajtojë këtë çështje ashtu sikur është vendosur në nenin 9.4 të LPP-së".

Paneli shqyrtues duke pasur parasysh faktin që Telekomi i Kosovës është autoritet publik dhe ofron shërbime profesionale të natyrës së këtij aktiviteti të prokurimit, dhe duke pasur parasysh faktin që AK- Universiteti publik "Universiteti "Hasan Prishtina", si autoritet kontraktues nuk e ka respektuar nenin 9.4 të LPP-së, atëherë ky aktivitet i prokurimit duhet të anulohet dhe të merret për bazë neni 9.4 i LPP-së.

Paneli shqyrtues duke pas parasysh faktin se parashtruesi i ankesës "Telekomi i Kosovës" sha, ankesës i ka bashkangjitur kopjen e shkresës, "Marrëveshje mbi shfrytëzimin e kontratës publike kornizë për ofrimin e shërbimeve Telekomunikuese të lidhur me Ministrin e Administratës Publike (MAP) dhe Telekomin e Kosovës"sha, me nr. prok: 202-16-102-215", ku objekt i marrëveshjes është ofrimi i shërbimeve të përshkruara

si: Shërbimet - Telefonike mobile, internet, internet për GPRS, kablli optik, shërbimet e telefonisë fikse, shërbimet e TV -kabllovik". Sipas përshkrimit, marrëveshja e njëjtë ka kohëzgjatje prej 36 muajve, përkatësisht nga data 01.04.2017, deri më datën 31.03.2020, Prandaj, sipas asaj që u përshkrua më lartë Autoriteti Kontraktues / Universiteti "Universiteti "Hasan Prishtina", dhe Operatori Ekonomik ankues, "Telekomi i Kosovës" sha, për shërbimin e kërkuar përmes kësaj procedure të prokurimit (Shërbimet e internetit , televizionit kabllor), kanë marrëveshje deri më datën 31.03.2020. Andaj duke u nisur nga ky fakt paneli shqyrtues sqaron se, nëse Telekomi i Kosovës nuk arrin ta përmbush kontratën e cekur si më lart sipas kushte dhe kritereve te kërkuara nga ana e autoritetit kontraktues, atëherë, autoriteti kontraktues mund ta shkëputë kontratën me ketë operator ekonomik sipas kushteve të parapara të

kontratës ekzistuese dhe se marrëdhëniet e tyre kontraktuale palët ti rregullojnë nëpërmjet gjykatës

kompetente sipas Ligjit mbi Marrëdhëniet Detyrimore apo edhe ligjeve tjera në fuqi.

Paneli shqyrtues vjen në përfundim se autoriteti kontraktues duke u bazuar sqarimeve te cekura si me lart për rastin konkret është i obliguar qe ti referohet dispozitave të lartcekura sepse KRPP ka dhen interpretimin e saj për raste te ngjashme.

Paneli shqyrtues konform nenit 117 të LPP-së, si dhe duke u bazuar në provat e prezantuara si më lart vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës themelore-Departamentit për çështje Administrative në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të këtij vendimi.

Kryesuesi i Panelit Shqyrtues

z. Goran Milenković

Vendimi t'i dorëzohet:

1x1 AK- Universiteti "Hasan Prishtina",

1x1 OE-"Telekomi i Kosovës" sha – Prishtinë

1x1 Arkivës së OSHP-së;

1x1 Për publikim në ueb- faqe të OSHP-së.